

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJËSI TE KUFIZUAR
"AMMO CONSTRUCTION" SH.P.K.**

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Sot më datë 31/07/2024, unë Eno Alia, I biri I Tonin-it, lindur më datë 19/01/2000, në Tiranë dhe banues në Rruga "Rr Perlat Rexhepi, Tiranë, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, I identifikuar me dokumentin tip letërnjoftim ID nr. 0330025760 dhe Numër Personal K00119036Q,

bazuar në legjislacionin në fuqi, veçanërisht bazuar në nenet 68 e vijues të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Shoqëritë tregtare", i ndryshuar, në Ligjin nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendrën Kombëtare te Regjistrimit, në Ligji nr. 131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", në dispozitat e Kodit Civil, në cilesinë e ortakut themelues si dhe në vullnetin tim të lirë të shprehur dhe në nenshkrimin e akteve të themelimit te shoqërisë kam hartuar aktin e themelimit dhe statutin e një shoqërie me pergjegjësi te kufizuar:

**KREU I
NENI 1**

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

(1) *Sot, më 31.07.2024, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me pergjegjësi të kufizuar me emrin **AMMO CONSTRUCTION**.shpk. (ne vijim Shoqëria), e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi sh.p.k*

(2) *Themeluesit e shoqërisë janë :*

1 - Eno Alia, I biri I Tonin-it, lindur më datë 19/01/2000, në Tiranë dhe banues në Rruga "Rr Perlat Rexhepi, Tiranë, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, I identifikuar me dokumentin tip letërnjoftim ID nr. 0330025760 dhe Numër Personal K00119036Q;

2 - James Doshi, i biri i Tomë-s, lindur me date 20.02.2000, në Australi dhe banues ne Rruga "Nokolla Zorraqi", Nd.11, H.1, Tirane, shtetas shqiptar me zotësi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me dokumentin tip letërnjoftim ID Nr. 034218785 dhe Numër Personal K00220048B

3- Even Babasi, I biri I Ndrichimit-it, lindur më datë 06/06/1999, në Tiranë dhe banues në Rruga "Rr. Free Ukraine, Tiranë, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, I identifikuar me dokumentin tip Pasaporte nr. BR2245344 dhe Numër Personal J90606062J;

(3) *Shoqëria mund te hap zyra përfaqësimi, dege dhe/ ose filiale, të marrë pjesë në shoqeri te tjera, të kryejë aktivitete në vende të tjera brenda apo jashtë territorit te Republikës se Shqiperisë. në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, që do te miratohen herë pas here.*

NENI 2 OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti I veprimtarise së shoqërisë është :


1. Aktivitet në fushën e ndërtimeve civile, industriale, turistike, bujqësore, ujesjells-kanalizime, punime rrugore
2. Projektim, ndërtim, montim, zbatim dhe rikonstruksion te godinave të të gjitha llojeve, rruge të çdo kategorie, autostrada, mbikalime, hekurudha, pista aeroportuale, punime nëntokësorë, ura vepra arti, vepra kullimi e vaditje, ndërtime hidroteknike, mbrojtje lumore, sisteme hidraulike e bonifikime, barriera dhe mbrojtje lumore, diga, tunele etj
3. Eksportimi, importimi, tregtimi i materialeve të ndertimit dhe aktivitete te lidhura me ndertimin.
4. Shfaqja, nxitja, promovimi i strukturave ckonomike, investuese dhe sipërmarrese në fushën c ndertimit të objekteve urbane e industrial
5. Organizimi, tregtimi dhe perfaqesimi i aktiviteteve tregtare në fushën e prodhimitarisë së materialeve të ndertimit.
6. Pjesëmarrja në prokurime dhe proçedura me qellim marrjen veprave apo objekteve publike dhe private për projektimin, konstruksionin, rikonstruksionin, dekoracion ndertimor civil, dhe ndertimin ne te gjithë ciklin e tij. Perfaqesimin e subjekteve juridike vendase apo të huaja me objekt të ngjashëm në teritorin e Republikës se Shqiperisë
7. Ne perputhje me legjislacionin shqipëtar, Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet nevojshme, i dobishëm apo ndihmës ne permbushjen e qëllimeve te mesipërme.

NENI 3 KOHËZGJATJA

Shoqeria do të ushtrojë aktivitetin e saj per një periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e themelimit te Shoqerise.

NENI 4 SELIA

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga Abdyl Frasheri", Pallati VESA CENTER, Tirane Albania
- (2) Adresa e shoqërisë per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon:
 - a) e-mail: ammoconstructionsphpk@gmail.com; b) Cel: +355 69 233 3334



NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100'000 (njëqindmijë) Lekë I përbërë nga tre (3) kuota

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues :

Eno Alia: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 34 000 (tridhjetë e kater mijë) lekë që përben 34% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ortaku: James Doshi, Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 33 000 (tridhjetë e tre mijë) lekë që përben 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

3. Ortaku: Even Babasi, Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 33 000 (tridhjetë e tre mijë) lekë që përben 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi I ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të pa luajtshme apo të drejta)

NENI 6 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

(1)Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

(2)Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

(3)Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

(4)Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 7 TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 8


ORGANI VENDIMMARRËS

- (1) Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- (2) Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- (3) Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- (4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblesë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- (5) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblesë e përgjithshme.
- (6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 9

MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

- (1) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- (2) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.



NENI 10 KUORUMI

(1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

(2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

(3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 11 MARRJA E VENDIMEVE

(1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

(2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;


(3) Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

NENI 12 PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.



NENI 13
ADMINISTRIMI

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator të parë të shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit:

Eno Alia.

Adresë : Tirane, Njesia Nr.5, rruga Perlat Rexhepi, Shqipëri


(emër, mbiemër, nënshkrim)

NENI 14
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

(2)Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padi të, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 15
PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

(1)Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

(2)Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose 6 solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.





3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare . kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

(5)Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

(6)Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

NENI 16 VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 17 EKSPERTËT

(1) Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetore dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

(2) Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorezojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V

NENI 18

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket merrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 19

RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 20

BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptarë.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 21

MOSMARRËVESHJET

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


ORTAKET

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR


AMMO CONSTRUCTION.shpk



Eno Alia



James Doshi



Even Babasi